


PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Objektivi kryesor i këtij Studimi është të analizojë politikën penale ndjekur nga sistemi gjyqësor në luftën kundër krimit të organizuar për periudhën 2005-2015. Duke qenë se sistemi gjyqësor është një ndër institucionet më të rëndësishme në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, është me rëndësi dhe interes që të shqyrtohen faktorët dhe standardet që merren në konsideratë dhe aplikohen në proceset gjyqësore me të pandehur të dyshuar për përfshirje në aktivitete të paligjshme të krimit të organizuar. Për të kuptuar politikën penale të sistemit gjyqësor ndaj krimit të organizuar, fillimisht u shqyrtua literatura, dhe më pas janë analizuar rreth 225 vendime të Gjykatës për Krime të Rënda (këtu e më poshtë referuar si “GJKR”), të periudhës 2005-2015, si dhe janë realizuar 10 intervista me eksperte të fushës (avokatë penalistë, gjyqtarë dhe prokurorë të krimeve të rënda). **Analiza është kryer duke u bazuar në 5 indikatorë të përzgjedhur:**



Politika penale është e lidhur ngushtësisht me cilësinë e ligjit si në kuptimin material dhe procedural të tij por edhe me qasjen e gjykatave. Ky Studim tregoi se cilësia e ligjit në kuptimin material por dhe qasja e gjykatave lë shumë vend për përmirësime.

Analiza e Indikatorit të “**gjykimit të shkurtuar**” i cili është një element procedural gjykimi, nënvizon se roli i gjykatës në këtë formë gjykimi lidhur me analizën e provave, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017, po bëhet deri diku pasiv duke e shmangur gjykatën nga procesi i debatimit të provave tek gjykimi i krimeve të rënda, një institucion thelbësor ky në rastin e gjykimit të çështjeve komplekse që lidhen me krimin e organizuar. Nëse gjykimi i shkurtuar ka përfitime që lidhen me uljen e ngarkesave në sistemin gjyqësor, në rastin e gjykatave të krimeve të rënda, të cilat nuk kanë të njëjtën ngarkesë që kanë gjykatat e krimeve të zakonshme, do duhej analizuar mire nga legjislatori sesi kjo procedurë gjykimi do të ndihmonte në luftën kundër krimit të organizuar në të gjitha format e tij. Duhet cilësuar se shmangia e gjykimit të shkurtuar për vepra penale të cilat dënohen me burgim të përjetshëm në ndryshimet e e Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017 është një hap cilësor në këtë drejtim.

Sidoqoftë, sindroma e amendimit të shpeshtë dhe të nxituar e Kodit Penal dhe atij të Procedurës luan një rol të rëndësishëm në interpretimin e gjykatave. Politika penale e gjykatave është e ndikuar nga fenomeni i “arrnimit” të legjislacionit penal në formë të pa studiuar në mënyrë thellësore dhe sistemike. Këtë e tregon edhe analiza e indikatorit të “interpretimit juridik”, i cili nxjerr në dukje mospërputhjen e vecorive të formave të krimit të organizuar, pasi për shembull, vecoritë dhe veprat penale në kuadrin e terrorizmit janë shumë më të specifikuar nga ligji se ato të kryera në kuadrin e organizatës kriminale apo bandës së armatosur.

Nga ana tjetër, shikohet se gjykatat e krimeve të rënda të nivelit të parë kanë një qasje më të zgjeruar përsa i përket interpretimit të neneve përkatëse që lidhen me format e vecanta të bashkëpunimit të kryerjes së veprave penale. Ndërkohë që Gjykata e Apelit dhe ajo e Lartë e interpretojnë ligjin ngushtësisht duke e bërë më të vështirë të provuarit e veçorive specifike të formave të ndryshme të bashkëpunimit të vecantë të trafikut të narkotikëve dhe krimeve të tjera të rënda, sidomos në rastin e organizatës kriminale.

Nga studimi i indikatorit të “interpretimit juridik” të krijohet ideja sikur Gjykatat e Krimeve të Rënda besojnë se krimi i organizuar shqiptar nuk është shumë i sofistikuar, madje se forma operative e tij tipike është ajo e “grupit të strukturuar”. Megjithatë në arsyetimet e saj, Gjykatat i japin shumë rëndësi strukturës organizative për të bërë dallimin midis bashkëpunimit të vecantë kundrejtë atij të thjeshtë, packa se ligji nuk kërkon që grupi i strukturuar të ketë strukturë të sofistikuar. Në të kundërt grupimi kriminal do të klasifikohet si **“organizatë kriminale”**.


Vihet re një farë konfuzioni në interpretimin e Gjykatave dhe dënimet përkatëse. Duke analizuar gjykimet e tyre, të krijohet përshtypja se Gjykatat i analizojnë vecoritë e grupimeve kriminale duke pasur parasysh konceptualisht organizatën kriminale, por dënimet i japin në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal, kjo edhe pse në disa raste prokuroria ka kërkuar që gjykimi të kryhet për organizatë kriminale. Në këtë kontekst, dënimet rezultojnë më të ulëta, duke vënë në pikëpyetje politikën penale të gjykatave. Një problem tjetër që lidhet me këtë qasje është se jurisprudenca ka avancuar në interpretimin juridik të grupit të strukturuar kriminal, por ka ngelur e pa zhvilluar në interpretimin e vecorive të grupimeve kriminale në kuadrin e organizatës kriminale. Kjo do të sjellë shumë vështirësi në kualifikimin e veprave penale në kuadrin e organizatës kriminale, duke bërë që në të ardhmen dënimi i formës më të lartë të bashkëpunimit të krimit të jetë minimal, faktor që ndikon në efektivitetin e goditjes nga gjyqesori të këtij krimi.

Në lidhje me luftën kundër narkotikëve, qasja e Gjykatave por edhe Prokurorisë duket se nuk është në përputje me problematikën që ka ky fenomen sot në Shqipëri. Sic e tregoi edhe analiza e indikatorit të “interpretimit juridik”, në periudhën 2005-2015 shumica dërmuese e veprave penale që lidhen me narkotikët është dënuar në kuadrin e bashkëpunimit të thjeshtë dhe jo atij të vecantë. Madje në vitet e fundit (2013-2015), trendi i dënimeve shkon në dënime individuale dhe jo në kuadër bashkëpunimi, ndërkohë kur dihet se është shumë e vështirë që të realizohet trafiku i narkotikëve brënda dhe jashtë vendit pa pasur koordinim dhe bashkëpunim të disa aktorëve. Kjo nënkupton se politika penale e Gjykatave, por edhe e Prokurorisë në luftën kundër narkotikëve ka nevojë të rishikohet.

Në lidhje me vlerësimin e indikatorit të **“masave të dënimit”** të zbatuara për krime të rënda, duke përfshirë vepra penale në fushën e narkotikëve, ky Studim zbulon se:

Gjatë periudhës 2006-2015, masa më e aplikuar e dënimit për autorë të veprave penale në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda është 5-10 vjet burgim (për 38% e numrit total të të dënuarve nga GJKR), ndërsa dënimi me gjobë është sanksioni penal më pak i zbatuar (për vetëm 1% të të dënuarve). Sanksioni më i ashpër penal, burgimi i përjetshëm, është dhënë në 125 raste (5 % të të dënuarve). Në përgjithësi, politika e dënimit penal e ndjekur nga gjykatat kompetente për krime të rënda ka qenë më e ashpër në fillimin e funksionimit të tyre, dhe është zbutur me kalimin e kohës. Konkretisht, masa e dënimit prej 10-25 vjet burgim njohu rritje në fillimet e veprimtarisë së gjykatës, duke kulmuar në vitin 2008 dhe që atëherë zbatimi i saj ka shënuar rënie. Rënie të ndjeshme ka shënuar dhe zbatimi i dënimit me burgim të përjetshëm, i cili nuk u aplikua në asnjë rast në vitin 2015. Nga ana tjetër, aplikimi i dënimeve mes 5-10 vjet burgim ka njohur rritje nga viti në vit. Rritje ka njohur gjithashtu dhe zbatimi i masave të dënimit nga 2-5 vjet burgim. Rritjen më të ndjeshme e ka njohur zbatimi i masave të buta të dënimit deri në 2 vjet burgim.

Luhatja ndër vite e masave të denimit



Grafik: Masa mesatare e dënimit për të pandehur, të kërkuar nga Prokuroria dhe caktuar nga Gjykata (3 nivele), sipas vendimeve gjyqësore të analizuar.

Nga të akuzuarit për vepra penale në fushën e narkotikëve, rezulton se 97% e tyre janë gjendur fajtorë në shkallë të parë. Masa e dënimit e caktuar më shpesh për ta ka qenë 5-10 burgim (56.2% të të dënuarve). Ky sanksion përbën në praktikë gjysmën e masës së dënimit të parashikuar nga neni 283/a/ 2 i Kodit Penal “Trafikimi i narkotikëve” (10-20 vjet burgim), e cila është dispozita më e referuar dhe gjykuar në periudhën 2006 – 2015. Në ndryshim nga vitet e shkuara, vitet e fundit, sidomos në vitin 2014 dhe 2015, pothuaj të gjitha çështjet e studiuara (të përzgjedhura rastësisht) për trafik narkotikësh paraqiten në formën e bashkëpunimit të thjeshtë apo dhe pa elementë bashkëpunimi. Mosgjjetja e elementëve të formave të veçanta të bashkëpunimit (organizata kriminale/grup i strukturuar kriminal) apo bashkëpunimit sipas neni 283/a/2 ka rezultuar në lehtësimin e pozitës së të pandehurve dhe rrjedhimisht në masa dënimi më të ulta.

Nga shqyrtimi i vendimeve gjyqësore për trafik narkotikësh rezulton shumica dërrmuese e të gjykuarve gjatë viteve 2013-2015, janë kryesisht persona në vështirësi ekonomike, studentë, të papunë dhe të padënuar më parë. Roli i tyre në veprimtarinë e paligjshme ka qenë dytësor (transportues, shofer) dhe nuk ka hetime apo akuza të ngritura ndaj organizatorëve, financuesve, porositësve apo blerësve me shumicë.

Nga ky studim, vihet re prirja e theksuar për të kërkuar pothuajse gjithmonë masën me natyrë përjashtimore “arrest me burg”. Të pandehurve për veprat penale të kryera në bashkëpunim u caktohet gjithmonë masa e sigurimit “arrest me burg”. Pavaresisht se mund të konsiderohet e arsyeshme mbajtja në arrest me burg duke marrë parasysh llojin e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit, arsyetimi i dhënë nga gjykata për nevojën e caktimit dhe përshtatshmërisë së masës së sigurimit “arrest me burg” nuk është i thelluar sa duhet për të konfirmuar natyrën

përrjashtimore të aplikimit të kësaj mase. Është e nevojshme që në vend që të përdoren frazat standarde duke i bërë referencë dispozitave procedurale ose perifrazimi i tyre, të jepen të dhëna sa më specifike mbi rrethanat dhe shkaqet e posacme që përlligjin dhe justifikojnë heqjen e lirisë të kryerësve të veprave penale. Nga ana tjetër, shihet që dhe argumentet e avokatëve që kundërshtojnë mbajtjen në arrest, janë sipërfaqësore dhe ka vend që të jenë më të plota.

Shumë nga rastet e veprave penale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, si psh. “Trafikim i narkotikëve, në bashkëpunim ose me shumë se një herë”, përmbajnë shumë proçedime të lidhura me më shumë se një të pandehur, si dhe shtyrje të seancave që ndikojnë në kohëzgjatje më të gjatë të gjykimit. Kohëzgjatja mesatare e gjykimit të trafikimit të narkotikëve të kryer në bashkëpunim në shkallë të parë zgjat mesatarisht 333 ditë. Ndër vite shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ardhur duke u ulur në frekuencë, por ndër shkaqet e zvarritjeve të gjykimeve rezulton të jenë mungesa e avokatëve mbrojtës të të pandehurve, ndryshimet e herëpashershme të tyre, mungesa e Prokurorëve apo kërkesat e tyre për seancë të vecantë për paraqitje të provave apo përgatitje të diskutimeve përfundimtare, mosformimin e trupit gjyqësor, apo mungesat e dëshmitarëve dhe vështirësia për t’i pasur në seancë.

Në mënyrë të përmbledhur ky Studim nxjerr në pah se drejtësia penale e sistemit gjyqësor në luftën kundër trafikut të narkotikëve në vecanti, dhe krimin të organizuar në përgjithësi, ka nevojë të rishikohet dhe të analizohet më tej. Paçka se kuadri ligjor penal problematik është një faktor i rëndësishëm në mungesën e efencës në luftën kundër krimin të organizuar, gjykatat kanë pasur kompetenca, të cilat jua jep ligji, që nëpërmjet “pushtetit” të intepretimit ligjor dhe dhënien e masave të dënimit të ndikojnë në një luftë më cilësore ndaj krimin të organizuar dhe trafikut të narkotikëve në vecanti. Ky Studim nxjerr në pah gjetje të cilat nënvizojnë se sistemi i drejtësisë ka lejuar hapësira që krimi i organizuar t’i shmanget drejtësisë.